

Fuqizimi i pacientëve për një shoqëri më të shëndetshme - Programi Vjetor i Punës 2025**Duration:** 01.01.2025 - 31.12.2025**Countries:**
North Macedonia**EU contribution:** € 53 476**Total budget:** € 79 816**Implementer:**Združenie za poddržka na lugeto što živeat so HIV –
Zaedno Posilni Skopje**Funded by the
European Union****Project description:**

Projekti synon të përmirësojë cilësinë e jetës së personave që jetojnë me HIV në Maqedoninë e Veriut, duke forcuar qasjen në trajtimin modern dhe duke promovuar një mjedis shëndetësor më gjithëpërfshirës dhe më mbështetës. Projekti do të ul stigmën dhe diskriminimin, duke siguruar që pacientët të kenë qasje në shërbime me dinjitet, respekt dhe pa pengesa. Duke kontribuar në një sistem shëndetësor më të përgjegjshëm, projekti mbështet rezultate më të mira shëndetësore dhe përfshirje sociale.

Njëkohësisht, projekti promovon rritjen e ndërgjegjësimit dhe zbulimin e hershëm, duke nxitur më shumë njerëz të kontrollohen dhe nëse është e nevojshme, të lidhen me shërbime cilësore për kujdes dhe mbështetje. Gjithashtu, forcon kapacitetet e organizatave të pacientëve për të avokuar për qasje të qëndrueshëm në ilaçe që shpëtojnë jetë dhe politika të përmirësuara të kujdesit shëndetësor. Përmes këtyre veprimeve, kontribuon në përpjekjet kombëtare dhe globale për t'i dhënë fund AIDS-it dhe për të ndërtuar një shoqëri më të shëndetshme dhe më të drejtë.

Expected results:

- Rritja e qasjes në trajtimin modern të HIV-it në kohë dhe me efektivitet për njerëzit që jetojnë me HIV;
- Ulja e stigmës dhe diskriminimit, duke çuar në një mjedis social dhe shëndetësor më gjithëpërfshirës dhe mbështetës;
- Nivele më të larta ndërgjegjësimi për statusin e HIV-it dhe përmirësim të lidhjes me shërbimet e kujdesit dhe mbështetjes;
- Progres i matshëm drejt arritjes së objektivave kombëtare dhe globale, për t'i dhënë fund AIDS-it;
- Forcimi i kapaciteteve të organizatave të pacientëve, për të avokuar për të drejtat e pacientëve dhe qasjen në ilaçe;
- Përfshirje më e madhe e pacientëve dhe shoqërisë civile në promovimin e të drejtave shëndetësore dhe përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.